



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2175/5 prot.

Datë 09/10/2023

V E N D I M

Nr. 1013/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/10/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. *REF-76226-07-27-2023*, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’*”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. *REF-76226-07-27-2023*, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’*”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës në lidhje me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ” në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Aida Construction” SHPK me NIPT: M03116403L dhe me adresë: Rr “BRIGADA XI SULMUESE, Lagjja “Apolonia”, Pallati në krah të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, 9301, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Adresa: Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Person i interesuar: Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK me NIPT: K07924803N dhe me adresë: Lagjja “Kastriot”, rruga “Andon Profka”, 2 kullat Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me

pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.07.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-76226-07-27-2023, me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Më datë 14.08.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 31.08.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “FRONTIER CONSTRUCTION” SHPK	0,00 leke	skualifikuar
2. “NIKA” SHPK	36.724.857,55 leke	skualifikuar
3. “INA” SHPK	42.650.692,00 leke	skualifikuar
4. “AIDA CONSTRUCTION” SHPK	42.738.983,71 leke	skualifikuar
5. “Shendelli” SHPK	42.990.349,71 leke	kualifikuar
6. “JOGI” SHPK	43.670.473,00 leke	skualifikuar
7. “2Z KONSTRUKSION” SHPK	43.736.050,55 leke	skualifikuar
8. “MODESTE” SHPK	44.045.164,26 leke	skualifikuar
9. “Caushi M” SHPK	48.665.574,00 leke	skualifikuar
10. “LEON KONSTRUKSION” SHPK	52.209.632,41 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 31.08.2023, operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “AIDA” SHPK me NUIS M03116403L dhe “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet:

”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”

Operatorit ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “EUROVIA_PUNE_E_NGJASHME...”, por nga verifikimi i kryer rezulton se puna e ngjashme nuk është realizuar nga “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, por nga subjekti “EUROVIA” SHPKNJ, Zhelinë, me numër tatimor MK28010513380, me seli në Rr.101, nr.15, fshati “Zhelinë”, e përfaqësuar nga Dr.Elmedin Ademi.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.6, ku përcaktohet:

“Operatori/ët ekonomik duhet të paraqes certifikatën e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent;
- ISO45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent;”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ ka paraqitur në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik):

- ISO 9001:2015, nr. certifikatë 0249C2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;
- ISO 14001:2015, nr. certifikatë 0241A2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;
- ISO 45001:2018, nr. certifikatë 0219S2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE,

si më sipër kërkuar, por fusha e certifikimit nuk rezulton të jetë e njëjtë me objektin që prokurohet.

3. Referuar Kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik, datë 14.08.2023, midis OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK dhe “EUROVIA” SHPKNJ, ngarkuar në SPE, në 2% e marrë përsipër nga “EUROVIA” SHPKNJ, nuk përcaktohen elementët (zërat sipas preventivit) që merr përsipër të realizojë ky operator në bashkim, referuar përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

4. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:

- Në preventivin “Punime Elektrike”, emërtimi i punimeve “Punime elektrike palestra”, në zërin me numër rendor 35, është ndryshuar numri i analizës.
- Në preventivin “Hidroteknik”, emërtimi i punimeve “Furnizimi me ujë Sanitar dhe Kanalizimi i Ujërave të zeza”, zërit me numër rendor 30 i është ndryshuar numri i analizës.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se në datën 01.09.2023 autoriteti kontraktor ka njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Shendelli” SHPK.

II.6. Në datën 06.09.2023 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3394, dhe me numër protokoll nr. 2175/2023, datë 06.09.2023 i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2175/2 prot, datë 06.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ” kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3394, dhe me numër protokoll nr. 2175/2023 datë 06.09.2023.

II.8. Me shkresën nr. 6451/20 prot, datë 15.09.2023 me objekt: “Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare ‘Naim Frashëri’”, protokolluar me tonën me nr. 2175/4 prot datë 18.09.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga

operatori ekonomik "Aida Construction" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës, si më poshtë vijon:

"Referuar pikave në Formularin e Ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomik "AIDA CONSTRUCTION" SHPK dhe "EUROVIA" shpknj, pretendohet se:

"REFERUAR KONTRATËS SË BASHKËPUNIMIT TË PËRKOHSHËM TË OPERATORËVE EKONOMIK DATË 14.08.2023 MIDIS OE AIDA CONSTRUCTION SH.P.K. DHE EUROVA SH.P.K.NJ. NË 2% TË MARRË PËRSIPËR NGA EUROVIA SH.P.K.NJ. NUK PËRCAKTOHEN ELEMENTËT QË MERR PËRSIPËR TË REALIZOJË EUROVIA SH.P.K.NJ .

• *Në lidhje me këtë arsye skualifikimi subjekti ankimues pretendon se nuk është në kushtet e skualifikimit, pasi ndarja e punimeve jo vetëm që është qartësuar në kontratë por bashkëngjitur kontrata ka edhe preventivin e detajuar në çdo zë që do marrë përsipër shoqëria.*

KSHA në lidhje me këtë parashtrim të subjektit ankues, pasi administroi nga SPE. dokumentacionin e DST-së (për kriteret e kualifikimit), marrëveshjen e bashkëpunimit dhe preventivin e paraqitur në SPE për këtë procedurë prokurimi nga BOE "AIDA CONSTRUCTION SHPK dhe "EUROVIA" shpknj, konstatoi se:

Në dokumentacionin e paraqitur në SPE, Marrëveshje_bashkëpunimi_AIDA_-_Eurovia.pdf.

KSHA evidenton se në preventiv nga BOE janë ndarë zërat sipas përqindjes së realizimit të punimeve për objektin e prokurimit, përkatësisht AIDA CONSTRUCTION" SHPK me 98% dhe "EUROVIA" SHPKNJ me 2%.

Pra, për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik "AIDA CONSTRUCTION" SHPK de "EUROVIA" shpknj qëndron.”.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se operatori ekonomik "Shendelli" SHPK ka paraqitur argumentet e tij lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Aida Construction" SHPK, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik (BOE) “AIDA” SHPK me NUIS M03116403L dhe “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet:

”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”

Operatorit ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “EUROVIA_PUNE_E_NGJASHME...”, por nga verifikimi i kryer rezulton se puna e ngjashme nuk është realizuar nga “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, por nga subjekti “EUROVIA” SHPKNJ, Zhelinë, me numër tatimor MK28010513380, me seli në Rr.101, nr.15, fshati “Zhelinë”, e përfaqësuar nga Dr. Elmedin Ademi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”, është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore përfundimtare.

Ne rastin e paraqitjes se ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).”.

III.1.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se BOE “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, për plotësimin e kriterit kualifikues të sipërpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë Bashkëpunimi “Për Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve”, datë 14.08.2023, të lidhur midis shoqërisë “AIDA KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: M03116403L dhe shoqërisë “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare ‘Naim Frashëri’“, ku shoqëria “AIDA KONSTRUKSION” SHPK do të realizojë 98% të punimebe, ndërsa shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ do të realizojë 2% të punimeve, sipas tabelës bashkëlidhur kësaj kontrate.

- Kontratë nr. 4561 rep, datë 02.12.2021, të lidhur midis shoqërisë ndërtuese “AIDA CONSTRUKSION” SHPK dhe shoqërisë investitore “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Kryerjen e punimeve sipas lejes së ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Roskovec numër vendimi 35, datë 15.07.2021 për ndërtimin e objektit: Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore me subjekt zhvillues “AM FRUITS” SHPK, fshati Suk 1”, me afat realizimi në përputhje me afatin e përcaktuar në lejen e ndërtimit, shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:
 - Leje ndërtimi nr. 53, datë 15.07.2021 të lëshuar nga Bashkia Roskovec për subjektin zhvillues “AM FRUITS” SHPK, me afat ndërtimi 10 muaj.
 - Faturë tatimore elektronike nr. 13, datë 03.03.2022, lëshuar nga shoqëria “AIDA CONSTRUKSION” SHPK për shoqërinë “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Sit. Nr.4 AM Fruit” dhe me vlerë 10.000.000 leke.
 - Faturë tatimore elektronike nr. 4, datë 02.11.2022, lëshuar nga shoqëria “AIDA CONSTRUKSION” SHPK për shoqërinë “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Situacion Nr.2 AMFRUIT” dhe me vlerë 6.240.000 leke.
 - Faturë tatimore elektronike nr. 7, datë 21.02.2022, lëshuar nga shoqëria “AIDA CONSTRUKSION” SHPK për shoqërinë “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Situacion Nr.3 Am Fruit” dhe me vlerë 4.800.000 leke.
 - Faturë tatimore elektronike nr. 16, datë 16.03.2022, lëshuar nga shoqëria “AIDA CONSTRUKSION” SHPK për shoqërinë “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Situacion Nr.5 AM AM Fruit” dhe me vlerë 12.500.000 leke.
 - Faturë tatimore elektronike nr. 2, datë 01.02.2022, lëshuar nga shoqëria “AIDA CONSTRUKSION” SHPK për shoqërinë “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Situacion Nr.1 AMFRUIT” dhe me vlerë 5.000.000 leke.
 - Aktkollaudimi, midis kollaudatorit z. Taqo Nicka, mbikqyrësit të punimeve “Arena MK” SHPK dhe sipërmarrësit të punimeve “AIDA CONSTRUKSION” SHPK.
 - Akti i Marrjes në Dorëzim, midis mbikëqyrësit të punimeve “Arena MK” SHPK dhe sipërmarrësit të punimeve “AIDA CONSTRUKSION” SHPK, si dhe investitorit “AM FRUITS” SHPK.
 - Situacion përfundimtar, i datës 01.05.2022.
 - Formular vlerësimi lëshuar nga investitori “AM FRUITS” SHPK për zhvilluesin e punimeve shoqërinë “AIDA CONSTRUKSION” SHPK.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Për Degët ose Zyrat e Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja”, i shoqërisë “EUROVIA” SHPKNJ, datë 05.07.2023, ku pasqyrohet se shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G është degë e shoqërisë së huaj EUROVIA SHPKNJ.
- Kontratë ndërtimi nr. 0307/11/01, datë 31.10.2017, të lidhur midis shoqërisë “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 dhe shoqërisë “Poliesterdej” SHPKNJ me numër tatimor: MK4030001416058, me objekt: “Ndërtimi i fabrikës industriale në lagjen Vizbeg, përfshirë të gjitha fazat e realizimit: gërmim, kallëpim, përforcim,

muratim, punë të çelikut, fasadim dhe hidroizolim dhe e gjithë kjo në përputhje me specifikacionet teknike të ofertës së pranuar nr. 003-10/2017 prej 12.10.2017”, me vlerë 77.454.600 denarë pa-TVSH.

- *Faturë nr. 17-300-00031, datë 13.03.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punime përgatitore (piketim objekti); Punë të tokës (Gërmim me makineri, gërmim manual, transport); Punime të betonit (Kallëpim, përforcim dhe betonim i stopave kaskadë, betonim i dobët); Punime të armatimit” dhe me vlerë 1.825.400 denare pa-TVSH.*
- *Faturë nr. 17-300-00050, datë 30.04.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punë të gërmimit; punë të betonit; punë të armimit dhe punë të infrastrukturës” dhe me vlerë 5.507.800 denare*
- *Faturë nr. 18-300-00074, datë 05.06.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punë të gërmimit; punë të betonit; punë të armimit dhe punë të çelikut” me vlerë 5.515.550 denare*
- *Faturë nr. 18-300-00093, datë 30.07.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punë të gërmimit; punë të betonit; punë të armimit, punë të çelikut, punë të mbulimit të çatisë, punë të infrastrukturës dhe tërheqje të faturës NR. 17-300-00091 dhe Aneks Nr. 0307/243/2” me vlerë 6.318.239,2 denare*
- *Faturë nr. 18-300-00103, datë 08.10.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punë të gërmimit; punë të betonit; punë të armimit, punë të çelikut, punë të mbulimit të çatisë, punë të fasadimit, punë të infrastrukturës dhe tërheqje të faturës NR. 17-300-00091 dhe Aneks Nr. 0307/243/2” me vlerë 19.398.163,13 denare*
- *Faturë nr. 18-300-00129, datë 28.12.2018, lëshuar nga shoqëria “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 për shoqërinë “Poliesterdej” SHPKNJP, me objekt: “Punë të fasadimit, punë të infrastrukturës dhe punë të paparashikuara” me vlerë 14.987.708,75 denare*
- *Raport përfundimtar për punimet e kryera i datës 04.12.2018, të hartuar midis shoqërisë ndërtuese “EUROVIA SHPKNJ” dhe shoqërisë përfituese “Poliesterdej” SHPKNJP.*
- *Akt-Marrje në dorëzim i objektit “Ndërtim i objektit industrial POLI 3” i datës 21.12.20218, midis palëve shoqërisë ndërtuese “EUROVIA SHPKNJ” dhe shoqërisë përfituese “Poliesterdej” SHPKNJP.*
- *Proces-verbal kolaudimi, i datës 21.12.2018, mbi kolaudimin e punimeve të objektit “Ndërtim i objektit industrial POLI 3” i datës 21.12.20218, midis palëve shoqërisë ndërtuese “EUROVIA SHPKNJ” dhe shoqërisë përfituese “Poliesterdej” SHPKNJP, si dhe kolaudatorit Ivica Mijalkov.*
- *Situacioni i gjashtë kohor, për punime të kryera përfshirë muajin Tetor – Dhjetor 2018.*

- Formular për realizimin me sukses të punimeve, të lëshuar nga shoqëria përfituese "Poliesterdej" SHPKNJP.

III.1.3. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se:

"Referuar parashtrimeve në Formularin e Ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomik "AIDA CONSTRUCTION" SHPK me NUIS M03116403L dhe "EUROVIA" shpknj me NUIS L91426009G, për arsyen e skualifikimit:

"Operatorit ekonomik "EUROVIA" SHPKNJ me NUIS L91426009G. në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin "EUROVIA PUNE E NGJASHME", por nga verifikimi i kryer rezultoi se puna e ngjashme nuk është realizuar nga "EUROVIA" SHPKNJ me NUIS L91426009G, por nga subjekti "EUROVIA" SHPKNJP, Zheline, me numër tatimor MK28010513380, me selinë: Rr. 101, nr. 15,. fshati "Zhelina", e përfaqësuar nga Dr. Elmedin Ademi."

Subjekti ankimues, pretendon se:

- *Shoqëria EUROVIA shpknj, nuk është një operator i pavarur nga EUROVIA shpknj, por është degë ose seli e kësaj shoqërie dhe eksperiencia e punës varet nga eksperiencia e Shoqërisë mëmë. Për rrjedhojë, puna e ngjashme është e vlefshme si eksperiencë pune mbështetur kjo edhe si analogji edhe mjaft procedurave të ndryshme që ka marrë pjesë shoqëria Eurovia sh.p.k.nj dhe në asnjë rast nuk ka përbërë kusht skualifikimi ky faktor".*

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumenteve të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit, dokumenteve të hedhura në sistem prej operatorëve ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të dosjes së tenderit, konstatoi se:

Bazuar në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit për degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja". KSHA vëren se për operatorin ekonomik EUROVIA shpknj me NUIS L91426009G forma ligjore e këtij subjekti është degë e shoqërisë së huaj me përfaqësues ligjor z. E. Shefiti.

Referuar ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit "Për degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja", të dhënat e shoqërisë së huaj EUROVIA SHPKNJ me formë ligjore Srl (shoqëri me përgjegjësi (e kufizuar) me përfaqësues ligjor z. E.Ademi.

Për objektin e prokurimit është ofertuar nga BOE "AIDA CONSTRUCTION" SHPK me NUIS M03116403L dhe "EUROVIA" shpknj me NUIS L91426009G, dhe dokumentacioni në përmbushje të kriterëve të kualifikimit sipas DST-së, në këtë bashkim operatorësh mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur mes OE AIDA CONSTRUCTION SHPK dhe EUROVIA shpknj, si dhe gjithë dokumentacioni financiar. Teknik dhe ligjor i paraqitur në SPE për

plotësimin e kriterëve të DST-së nga EUROVIA shpknj është paraqitur nga dega e shoqërisë së huaj me NUIS L91426009G.

Ndërkohe për përmbushjen e kriterit 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

A. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

B. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nga EUROVIA shpknj me NUIS L91426009G për plotësimin e këtij kriteri.

Për sa me sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik "AIDA CONSTRUCTION" SHPK dhe "EUROVIA" shpknj nuk qëndron.”.

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.5. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

III.1.6. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk

duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.7. Në nenin 9 “*Degët dhe zyrat e përfaqësimit*” të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.

2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të saj.

4. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.

5. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen sipas kërkesave të neneve 26 pika 4, 28 pika 5 dhe 37 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

6. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe nën emrin e saj.”.

III.1.8. Në nenin 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar përcaktohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi

duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*
- 4. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*
- 5. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*
- 6. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
- 7. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Fillimisht KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të kërkesës kualifikuese lidhur me eksperiencën e mëparshme, të dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues dhe të arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ky ankimues.

Fillimisht, referuar dokumenteve të tenderit, vërehet se procedura e prokurimit objekt-prokurimi është procedurë e llojit “Punë publike” dhe konkretisht autoriteti kontraktor kërkon që të realizojë kryerjen e punimeve civile **“Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’”**. Gjithashtu, në dokumentet e tenderit të modifikuara dhe konkretisht në Shtojcën 7, pika 2.3.1 ka përcaktuar kriterin kualifikues lidhur me punimet e mëparshme të ngjashme, ku nga ana e entit prokurues është përcaktuar që operatorët ekonomikë ofertues për përmbushjen e këtij kriteri duhet që të kenë realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të punimeve të mëparshme të ngjashme, ku në rastin e paraqitjes së një kontrate të vetme punimesh civile duhet që kjo kontratë të ketë vlerën jo më pak se 50% të fondit limit që prokurohet, ndërsa në rastin kur paraqet disa kontrata të ngjashme punimesh civile duhet që të gjitha së bashku të kenë një vlerë jo më pak se dyfishi i vlerës së fondit limit që prokurohet. Për të vërtetuar se kanë realizuar punime të ngjashme, operatorët ekonomikë ofertues duhet që të dorëzojnë dëshmi për realizimin e këtyre punimeve civile, ku si dëshmi në rastin e realizimit të punimeve civile të mëparshme me ente publike kërkohen që të dorëzohen kontrata e shoqëruar me formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, me situacionin përfundimtar të objektit dhe me aktin e kolaudimit, ndërsa si dëshmi rasti i realizimit të punimeve civile të mëparshme me subjekte private, kërkohen që të dorëzohen kontrata e sipërmarrjes e shoqëruar me formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, me situacionin përfundimtar të objektit, me aktin e kolaudimit dhe me fatura tatimore përfundimtare.

Në rastin kur ofertuesi është bashkim operatorësh ekonomik, në dokumentet e tenderit të modifikuara dhe konkretisht në Shtojcën 7, pika 2.3.1 autoriteti kontraktor në mbështetje të përcaktimeve të nenit nenin 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar, ka përcaktuar se në rastin kur secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë paraqet nga një kontratë të vetme për të vërtetuar realizimin me sukses të punimeve civile të ngjashme gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, duhet që vlera e kontratës së ngjashme të paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë që ka përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes në këtë bashkim, të jetë jo

më e vogël se 50% e fondit limit që prokurohet, ndërsa vlera e kontratës së ngjashme e paraqitur nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomik, të jetë në raport me përqindjen e bashkëpunimit mbi vlerën 50% të fondit limit, ndërkohë që në rastin kur secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë paraqesin më shumë se një kontratë të vetme për të vërtetuar realizimin me sukses të punimeve civile të ngjashme gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, duhet që shumatorja e vlerave të kontratave të ngjashme të paraqitura nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jenë jo më të vogla se përqindja e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në këtë bashkim, në raport me dyfishin e fondit limit që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të sipërcituar, konstatohet se kjo ofertë është paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ” ku shoqëria “Aida Konstruktion” SHPK do të realizojë 98% të punimeve civile objekt-prokurimi, ndërsa shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ do të realizojë 2% të punimeve civile objekt-prokurimi. Gjithashtu, nga shqyrtimi i ekstraktit të regjistrit tregtar të shoqërisë “EUROVIA” SHPKNJ u konstatua, se kjo shoqëri është degë e shoqërisë së huaj “EUROVIA” SHPKNJ me seli në Tetovë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përmbushje të kriterit për shërbime të ngjashme të realizuara gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, u konstatua se shoqëria “AIDA KONSTRUKSION” SHPK ka paraqitur një kontratë të vetme dhe konkretisht kontratë nr. 4561 rep, datë 02.12.2021, të lidhur me shoqërinë investitore “AM FRUITS” SHPK, me objekt: “Kryerjen e punimeve sipas lejes së ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Roskovec numër vendimi 35, datë 15.07.2021 për ndërtimin e objektit: Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore me subjekt zhvillues “AM FRUITS” SHPK, fshati Suk 1”, ndërsa shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ ka paraqitur një kontratë të vetme dhe konkretisht kontratë ndërtimi nr. 0307/11/01, datë 31.10.2017, të lidhur midis shoqërisë mëmë “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 dhe shoqërisë “Poliesterdej” SHPKNJP me numër tatimor: MK4030001416058, me objekt: “Ndërtimi i fabrikës industriale në lagjen Vizbeg, përfshirë të gjitha fazat e realizimit: gërmim, kallëpim, përforcim, muratim, punë të çelikut, fasadim dhe hidroizolim dhe e gjithë kjo në përputhje me specifikacionet teknike të ofertës së pranuar nr. 003-10/2017 prej 12.10.2017”, me vlerë 77.454.600 denarë pa TVSH.

Në arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave më datë 31.08.2023 është argumentuar se: “Operatori ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “EUROVIA PUNE E NGJASHME...”, por nga verifikimi i kryer rezultoi se puna e ngjashme nuk është realizuar nga “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, por nga subjekti “EUROVIA” SHPKNJ, Zhelinë, me numër tatimor MK28010513380, me seli në Rr.101, nr.15, fshati “Zhelinë”, e përfaqësuar nga Dr.Elmedin Ademi.”, si dhe duke mos e konsideruar të përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se sipas përcaktimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, anëtari i bashkimit të shoqërive “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”

dhe konkretisht shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G ka dorëzuar kontratën për punime civile të lidhur dhe të përmbushur nga shoqëria mëmë dhe konkretisht shoqëria e huaj “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: MK28010513380, ku sipas parashikimeve të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G duke qënë se është degë e shoqërisë së huaj “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: MK28010513380, ka të njëjtin personalitet juridik me këtë të fundit, si dhe vepron në emër të kësaj të fundit, pra kontrata e ndërtimit nr. 0307/11/01, datë 31.10.2017, të lidhur midis shoqërisë mëmë “EUROVIA SHPKNJ” me numër tatimor: MK28010513380 dhe shoqërisë “Poliesterdej” SHPKNJ me numër tatimor: MK4030001416058, me objekt: “Ndërtimi i fabrikës industriale në lagjen Vizbeg, përfshirë të gjitha fazat e realizimit: gërmim, kallëpim, përforcim, muratim, punë të çelikut, fasadim dhe hidroizolim dhe e gjithë kjo në përputhje me specifikacionet teknike të ofertës së pranuar nr. 003-10/2017 prej 12.10.2017”, me vlerë 77.454.600 denarë pa TVSH e dorëzuar nga shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G në këtë procedurë prokurimi është realizuar nga shoqëria mëmë “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: MK28010513380 dhe është dëshmi që edhe dega e kësaj shoqërie të huaj dhe konkretisht shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G ka realizuar punime civile, pasi ky i fundit ka të njëjtin personalitet juridik dhe vepron në emër të shoqërisë së huaj “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: MK28010513380.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G në cilësinë e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ” e ka përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara, në raport me përqindjen e bashkëpunimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Aida Construction” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.6, ku përcaktohet:

“Operatori/ët ekonomik duhet të paraqes certifikatën e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent;
- ISO45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent;”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ ka paraqitur në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik):

- ISO 9001:2015, nr. certifikatë 0249C2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;

- ISO 14001:2015, nr. certifikatë 0241A2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;
- ISO 45001:2018, nr. certifikatë 0219S2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE,
si më sipër kërkuar, por fusha e certifikimit nuk rezulton të jetë e njëjtë me objektin që prokurohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti Teknik”, është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqese certifikaten e cilesise se punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune) ose ekuivalent;

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.”.

III.2.2. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, janë publikuar zërat e punimeve objekt prokurimi, si më poshtë:



BASHKIA FIER
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER

DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

Adresa: L. "Kastriot": Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr.15 Fier - SHQIPËRI TëL: +355 34 410 650 website:bashkiafier.gov.al

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ARMANDO SUBASHI



PERMBLEDHJA E PREVENTIVAVE

Objekti : Rikonstruksioni i shkolles "Naim Frasheri" , Fier

Nr	Emertimi	Vlera (me tvsh)
1	Punime te brendshme ndertimore ne objektin ekzistues	
2	Punime konstruksioni ne shtesen anesore	
3	Punime ndertimore ne shtesen anesore	
4	Punime elektrike ne objektin ekzistues dhe shtesen anesore	
5	Punime hidroteknike dhe mnz ne objektin ekzistues dhe shtesen anesore	
6	Punime IT ne objektin ekzistues dhe shtesen anesore	
	TOTALI	

III.2.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se BOE "Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ", për plotësimin e kriterit kualifikues të sipërpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shoqëria "AIDA KONSTRUKSION" SHPK:

1. *Certifikatë EN ISO 9001:2015, lëshuar nga kompania certifikuese "AQScert" për shoqërinë "AIDA KONSTRUKSION" SHPK, me objekt: "Ndërtime dhe projektme të objekteve civile, industriale bujqësore, sociale kulturore, turistike, rrugë ujësjellës-kanalizime dhe të efincës së energjisë. Tregtim dhe montim i pajisjeve për ambientet frigoriferike. Tregtimi dhe montimi i pajisjeve për sera bujqësore. Tregtimi dhe montimi i produkteve agro-ushqimore.."*
2. *Certifikatë EN ISO 14001:2015, lëshuar nga kompania certifikuese "AQScert" për shoqërinë "AIDA KONSTRUKSION" SHPK, me objekt: "Ndërtime dhe projektme të objekteve civile, industriale bujqësore, sociale kulturore, turistike, rrugë ujësjellës-kanalizime dhe të efincës së energjisë. Tregtim dhe montim i pajisjeve për ambientet frigoriferike. Tregtimi dhe montimi i pajisjeve për sera bujqësore. Tregtimi dhe montimi i produkteve agro-ushqimore.."*
3. *Certifikatë ISO 39001:2012, lëshuar nga kompania certifikuese "AQScert" për shoqërinë "AIDA KONSTRUKSION" SHPK, me objekt: "Ndërtime dhe projektme të objekteve civile, industriale bujqësore, sociale kulturore, turistike, rrugë ujësjellës-kanalizime dhe të efincës së energjisë. Tregtim dhe montim i pajisjeve për ambientet frigoriferike.*

Tregtimi dhe montimi i pajisjeve për sera bujqësore. Tregtimi dhe montimi i produkteve agro-ushqimore..”.

- 4. Certifikatë ISO 45001:2018, lëshuar nga kompania certifikuese “AQScert” për shoqërinë “AIDA KONSTRUKSION” SHPK, me objekt: “Ndërtime dhe projektme të objekteve civile, industriale bujqësore, sociale kulturore, turistike, rrugë ujësjellës-kanalizime dhe të efëncës së energjisë. Tregtim dhe montim i pajisjeve për ambientet frigoriferike. Tregtimi dhe montimi i pajisjeve për sera bujqësore. Tregtimi dhe montimi i produkteve agro-ushqimore..”.*

Shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ

- 1. Certifikatë EN ISO 14001:2015, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, WAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.*
- 2. Certifikatë EN ISO 39001:2012, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit,*

sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, WAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.

3. *Certifikatë EN ISO 45001:2018, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosantare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, WAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.*
4. *Certifikatë EN ISO 50001:2018, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve term sanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe*

supervizim i rrjeteve LAN, ËAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.

5. *Certifikatë BS PAS 99:2012, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sistemeve aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, ËAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.*
6. *Certifikatë EN ISO 9001:2015, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sistemeve aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, ËAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.*

7. *Certifikatë EN ISO 27001:2013, lëshuar nga kompania certifikuese “CERTIS” për shoqërinë “EUROVIA” SHPKNJ, me objekt: “Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, impianteve e pajisjeve termosanitare, pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë të tjerë të lidhura me to. Import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë e pajisjeve industriale, elektrike, elektroshtëpiake, artikujve të mobilerisë etj. Import-eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamionë mjete bujqësore. Riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbim printimi. Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të lonisë, sistemeve të alarmit, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve të biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekësore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratorë, radio ndërlidhje, sistemeve me fibër optike etj. Projektim dhe zbatim të Hec-ve. Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, WAN, MAN. Import-eksport reagentë, kimikate materiale konsumi spitalore e laboratorike. Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: uniforma për ushtrinë dhe policinë.”.*

III.2.4. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, preventivave të punimeve, ku përfshihen punime elektrike, punime ndërtimore, punime konstruksioni, punime hidroteknike dhe punime IT-objekt-prokurimi, Komisioni konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që ofertuesit pjesëmarrës në procedurë të paraqesin certifikatën e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet dhe konkretisht certifikatën ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent; certifikatën ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent dhe certifikatën ISO 45001:2018.

III.2.6. Së pari, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik nuk konstaton, që certifikatat e cilësisë së punimeve të sipërpërmendura të paraqitura nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues duhet të kenë në fushën e aktivitetit zërat e

punimeve objekt - prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, pasi referuar kritereve të veçanta të kualifikimit **nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e posaçme nga ana e autoritetit kontraktor që certifikatat e cilësisë së punimeve ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 të ofertuesve duhet të kenë në fushën e aktivitetit të përfshirë zërat e punimeve objekt-prokurimi.**

Së dyti, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues “EUROVIA” SHPKNJ ka dorëzuar certifikatat e kërkuara në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ku në fushën e aktivitetit janë të përfshira disa nga zërat e punimeve objekt - prokurimi, si punime elektrike, punime IT-je, punime hidraulike, punime të impianteve e pajisjeve termosantare, punime të pajisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesorë.

Për sa i përket arsyes së mësipërme të skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron, pasi nga ana e autoritetit kontraktor në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është përcaktuar se objekti i aktivitetit për të cilën janë lëshuar certifikatat ISO të kërkuara në këtë kriter të kenë të përfshirë objektin e prokurimit dhe konkretisht zërat e punimeve objekt-prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 5 të këtyre dokumenteve të tenderit.

Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duhet të paraqesin të dhëna mbi modelin, llojin dhe kategorinë e produktit që ofrojnë, ndërkohë operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” duke deklaruar, se produktet që ka ofruar përmbushin specifikimet teknike, ndërkohë që gjatë zbatimit të kontratës është përgjegjësi e autoritetit kontraktor që të kujdeset që operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit të lëvrojë mallrat objekt-prokurimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit për të cilën është shpallur fitues.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi operatorit ekonomik ofertues është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se certifikatat ISO të paraqitura plotësojnë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi në fushën e aktivitetit të këtyre certifikatave janë të përfshira disa nga zërat e punimeve objekt - prokurimi, ndërkohë që Komisioni gjykon, se përfshirja e të gjithë zërave të punimeve objekt - prokurimi, mund të jetë e pamundur për t’u pasqyruar në certifikatat ISO të lëshuara nga organet certifikuese.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “3. Referuar Kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik, datë 14.08.2023, midis OE “AIDA

CONSTRUCTION” SHPK dhe “EUROVIA” SHPKNJ, ngarkuar në SPE, në 2% e marrë përsipër nga “EUROVIA” SHPKNJ, nuk përcaktohen elementet (zërat sipas preventivit) që merr përsipër të realizojë ky operator në bashkim, referuar përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*”, pika 1 “*KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT*”, është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.”.*

III.3.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se BOE “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”, për plotësimin e kriterit kualifikues të sipërpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- *Kontratë Bashkëpunimi “Për Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve”, datë 14.08.2023, të lidhur midis shoqërisë “AIDA KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: M03116403L dhe shoqërisë “EUROVIA” SHPKNJ me NIPT: L91426009G, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare ‘Naim Frashëri’“, ku shoqëria “AIDA KONSTRUKSION” SHPK do të realizojë 98% të punimeve, ndërsa shoqëria “EUROVIA” SHPKNJ do të realizojë 2% të punimeve, sipas tabelës bashkëlidhur kësaj kontrate.*
Gjithashtu në tabelën bashkëlidhur kësaj kontrate janë përcaktuar zërat e punimeve të dhëna në preventivin e publikuar në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik krijuar me kontratën e datës 14.08.2023.

III.3.4. Referuar shkresës nr. 6451/20 prot, datë 15.09.2023 me objekt: “*Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Akesës (KSHA) në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare ‘Naim Frashëri’”, protokolluar me tonën me nr. 2175/4 prot datë 18.09.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Aida Construction” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës, si më poshtë vijon:*

“Referuar pikave në Formularin e Ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK dhe “EUROVIA” shpknj, pretendohet se:

“REFERUAR KONTRATËS SË BASHKËPUNIMIT TË PËRKOHSHËM TË OPERATORËVE EKONOMIK DATË 14.08.2023 MIDIS OE AIDA CONSTRUCTION SH.P.K. DHE EUROVA SH.P.K.NJ. NË 2% TË MARRË PËRSIPËR NGA EUROVIA SH.P.K.NJ. NUK PËRCAKTOHEN ELEMENTËT QË MERR PËRSIPËR TË REALIZOJË EUROVIA.

• Në lidhje me këtë arsye skualifikimi subjekti ankimes pretendon se nuk është në kushtet e skualifikimit, pasi ndarja e punimeve jo vetëm që është qartësuar në kontratë por bashkëngjitur kontrata ka edhe preventivin e detajuar në çdo zë që do marrë përsipër shoqëria.

KSHA në lidhje me këtë parashtrim të subjektit ankues, pasi administroi nga SPE dokumentacionin e DST-së (për kriteret e kualifikimit), marrëveshjen e bashkëpunimit dhe preventivin e paraqitur në SPE për këtë procedurë prokurimi nga BOE “AIDA CONSTRUCTION SHPK dhe “EUROVIA” shpknj, konstatoi se:

Në dokumentacionin e paraqitur në SPE, Marrëveshje_bashkëpunimi_AIDA_-_Eurovia.pdf.

KSHA evidenton se në preventiv nga BOE janë ndarë zërat sipas përqindjes së realizimit të punimeve për objektin e prokurimit, përkatësisht AIDA CONSTRUCTION” SHPK me 98% dhe “EUROVIA” SHPKNJ me 2%.

Pra, për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK de “EUROVIA” shpknj qëndron.”.

III.3.5. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”.

III.3.6. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit 11 kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, duke qenë se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i ngritur nga Autoriteti Kontraktor për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes e ka pranuar pretendimin në ankesë për këtë pikë, atëherë Komisioni Prokurimit Publik do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pikë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankimin elektronik me nr. A/2023/3394, dhe me numër protokoll nr. 2175/2023, datë 06.09.2023 të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “4. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:

- Në preventivin “Punime Elektrike”, emërtimi i punimeve “Punime elektrike palestra”, në zërin me numër rendor 35, është ndryshuar numri i analizës.
- Në preventivin “Hidroteknik”, emërtimi i punimeve “Furnizimi me ujë Sanitar dhe Kanalizimi i Ujrave të zeza”, zërit me numër rendor 30 i është ndryshuar numri i analizës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në Seksioni I: “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, pika B “PËRGATITJA E OFERTAVE”, nënpika 4 “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve”, nënpika 6 “Çmimet” dhe nënpikën 10 “Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave” të dokumenteve të tenderit është përcaktuar, si më poshtë:

[...]

- 1. Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve** *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.*
Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.
- 2. Çmimet**
- 1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.*
 - 2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).*
Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të apo çmimet e tyre.
 - 3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.*
 - 4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.*
Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini –

konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

- 3. *Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave*** *Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.*

[...]

III.4.2. Në Seksioni II: “*LISTA E SHTOJCAVE*”, të dokumenteve të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë publikuar lista e shtojcave dhe shtojcat pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve, si më poshtë:

SEKSIONI II:LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

III.4.3. Në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar Shtojca 2 “*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT*” dhe preventivet e punimeve, ku në preventivin e punimeve elektrike zëri i punimit nr. 35 dhe në preventivin e punimeve hidroteknike zëri i punimit nr. 30, janë publikuar si më poshtë vijon:

Preventivi i punimeve elektrike:

35	2.a-120	F.v Buton sinjalizimi zjarri	cope	1		
36	2.a-117	F.v Sirene e jashtme lajmeruese	cope	1		
37	An	F.v Kuader sinjalizimi zjarri I adresueshem 230v/12v 24h autonomi	cope	1		
38	3.497	Germim dheu per elektrodat e tokezimit dhe kanal kabili	m3	5		
39	2.a-116	F.v Sirene e brendshme lajmeruese	cope	1		
			Shuma 2		0	
			Shuma 1+2		0	
			Fond rezerve 3 %		0	
			Shuma		0	
			T.V.SH 20%		0	
			Totali		0	

Preventivi i punimeve hidroteknike:



PREVENTIV

OBJEKTI :RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES 9 VJECARE "NAIM FRASHERI",FIER

Nr.	Analize	Emertimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
Furnizimi me uje sanitar dhe Kanalizimi i ujerave te zeza						
1	2.491/a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t = 2.0 mm, PN 10	mi	120		
2	2.491/b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 2.0 mm, PN 10	mi	80		
3	2.491/c	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=32mm, t = 2.4 mm, PN 10	mi	22		
4	2.491/d	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, PN 10	mi	60		
5	2.494/5	F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm	cope	3		
6	2.491/e	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10	mi	23		
7	2.494/4	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm	cope	2		
8	2.494/3	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm	cope	2		
9	2.494/2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	cope	5		
10	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	cope	46		
11	2.501	F.V WC aliafrenge importi	cope	4		
12	2.504	F.V WC aliafurka importi	cope	20		
13	2.495	F.v lavaman porcelani importi me mishelator	cope	16		
14	An	F.v lavaman porcelani (PAK)	cope	1		
15	An	F.V WC aliafrenge(PAK)	cope	1		
16	An	F.V Shufra metalike (PAK)	cope	1		
17	An - 16	F.V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	cope	8		
18	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50 mm	cope	9		
19	2.522	Tub kanalizimi pvc Ø 170 mm	mi	20		
20	2.523	Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm	mi	50		
21	2.521	Tub kanalizimi pvc Ø 140 mm	mi	32		
22	2.520	Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm	mi	90		
23	2.516/1	F.V Tuba e rakorderi PVC (Tub kanalizimi pvc Ø50 mm) 0.68 kg/ml	kg	60		
24	An - 11	F.V rezervuari zingato 5000 litra	cope	2		
25	An - 17	F.V pompe me pulmon 24 litra	cope	1		
26	2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3	7		
27	2.426/3	Prishje shtrese betoni	m3	14		
28	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ² , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoris III, me shk ne mjet	m3	48		
29	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	10		
30	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	23		
31	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	cope	1		
32	2.261	Shtrese rere	m3	18		
33	An - 19	Pusetete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm	cope	2		
34	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	10		
				Shuma 1		
Kanalizimet e ujerave te shiut						
1	An - 22	Pusetete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri	cope	4		
2	An - 19	Pusetete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm	cope	1		
3	2.523	Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm	mi	60		

III.4.4. Në dokumentacionin e ofertës nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues AIDA KONSTRUKSION SHPK & EUROVIA SHPKNJ” është dorëzuar Shtojca 2 “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT” dhe preventivet e punimeve të vulosura dhe fimosura nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisht, ku në preventivin e punimeve elektrike zëri i punimit nr. 35 dhe në preventivin e punimeve hidroteknike zëri i punimit nr. 30, janë plotësuar, si më poshtë vijon:

Preventivi i punimeve elektrike:

	2.3-120	F s Buton sinjalizimi zjarri	cope	1	2500	2500
--	---------	------------------------------	------	---	------	------

Preventivi i punimeve hidroteknike:

30	2.256	Nenshtrese zhavori	m3	23	1200	27600
----	-------	--------------------	----	----	------	-------

III.4.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/ve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit;

ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij;

b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij;

c) nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur;
- në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/et e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

5. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të

ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik.

Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.

Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.

Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete.

6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.”.

III.4.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.4.7. Lidhur me arsyen e skualifikimit, Komisioni konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar oferta ekonomike sipas Shtojcës 2 të dokumenteve të tenderit dhe sipas preventiveve të publikuara në sistemin elektronik të prokurimit, por në zërin e punimit nr. 35 të preventivit të punimeve elektrike në palestër dhe në zërin e punimit nr. 30 të preventivit të punimeve hidroteknike konstatohet, se zëri i analizës së çmimit për secilin nga këto zëra punimesh është i ndryshëm nga zëri i analizës të këtyre zërave i publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër Komisioni konstaton, se përshkrimi dhe volumi i këtyre zërave të preventivit është i njëjtë me përshkrimin dhe volumin e këtyre zërave të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit.

Lidhur me arsyen e mësipërme të skualifikimit, Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi ndryshimi i zërit të analizës nuk e bën ofertën ekonomike të paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues të pavlefshme dhe për më tepër kjo ofertë ekonomike nuk është në kushtet e skualifikimit të përcaktuara në nenin 82 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu Komisioni gjykon, se zërat e analizave të përcaktuara në secilin prej zërave të preventivit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit nuk është detyruese për ofertuesit, por është thjesht orientuese, pasi këto zëra analizash vendosen duke pasur parasysh analizat e çmimeve në ndërtim të miratuar më VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve

për zërat e punimeve në ndërtim” dhe ku ky akt nënligjor është baza ku mbështeten autoritetet kontraktore në hartimin e projektpreventivave që prokurojnë.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se oferta ekonomike e dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”, është e vlefshme dhe përmbush kushtet e nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë shqyrtimin administrativ për pjesën e pranuar të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-76226-07-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’*”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-76226-07-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’*”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”, duke e kualifikuar atë.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPKNJ*”.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

